

20151935350

L I G J

PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE DOJÇE BANKA DHE ERSTE BANKA SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIM TË PROJEKTIT „GAZIFIKIMI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË–FAZA 1 - SEGMENTI RRUGOR SH TIP – NEGOTINË – MANASTIR DHE SEGMENTI RRUGOR SHKUP-TETOVË - GOSTIVAR”

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet me hua te Dojçe Banka dhe Erste Banka në shumë deri 90.000.000 euro, të dedikuar për financim të Projektit “Gazifikimi i Republikës së Maqedonisë – faza 1-segmenti rrugor Shtip-Negotinë –Manastir dhe segmenti rrugor Shkup-Tetovë-Gostivar”.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e përdorimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen me Marrëveshje për hua, që do të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Dojçe Bankës dhe Erste Bankës.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Të gjitha obligimet që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji si dhe servisimi i huas do të kryhet me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua.

Neni 4

Huaja nga neni 1 i këtij ligji, do të tërhiqet në shtatë transhe, në pajtim me afatet dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen për hua.

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është shtatë vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej tri vitesh.

Shkalla e kamatës do të përcaktohet në ditën e nënshkrimit të Marrëveshjes për hua, varësisht nga ajo se cila shkallë e kamatës është më e volitshme për Republikën e Maqedonisë (fikse apo variabile). Shkalla kamatore variabile do të përllogaritet si shumë prej 6m EURIBOR + margjinë prej 450bps, kurse shkalla fikse e kamatës si shumë prej margjinës prej 450bps + shtrirje variabile. Shpenzimi i kamatës do të paguhet në nivel gjysmëvjetor.

Para tërheqjes së parë të mjeteve të huas, do të paguhet provizion i njëhershëm në shumë prej 1,50% të shumës së huas.

Për shumën e mjeteve të patërhequra nga huaja nga neni 1 i këtij ligji, do të paguhet provizion në shumë prej 2,47% në nivel vjetor.

Shfrytëzimi i mjeteve do të kryhet në pajtim me planin për tërheqje të mjeteve të huas, të përcaktuar në Marrëveshjen për hua, e në rast kur plani për tërheqje të mjeteve do të shmanget nga dinamika e realizimit të projektit, mjetet do të shfrytëzohen për përkrahje buxhetore.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella gjatë implementimit të projektit nga neni 1 i këtij ligji, Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Resurset energjetike maqedonase SHA Shkup do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Në procedurat për ndarjen e furnizimeve publike për implementimin e projektit të nenit 1 të këtij ligji, nuk mund të marrin pjesë persona fizikë ose juridikë të cilët janë lëndë ose mbi të cilët zbatohen masa restriktive të vendosura me rezoluta juridike obliguese të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në bazë të Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, me aktet juridike të Bashkimit Evropian, të vendosura nga Qeveria e SHBA-së, nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, duke përfshirë edhe nga Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore, nga Sekretariati Shtetëror Zvicëran për Punë Ekonomike dhe nga Ministria e Financave e Japonisë, si dhe nga organe tjera relevante qeveritare apo rregullatore, institucione ose agjenci të ngarkuara për zbatimin e sanksioneve ekonomike ose financiare.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".